



A.nr.613/2026

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës–Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj-Demi, kryetare, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Eshref Shabani, anëtarë, me Argjenda Sherifi, në cilësinë e procesmbajtëses, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.613/2026, të datës 09.06.2026, të parashtruar nga F.B, nga Prishtina, kundër organit të punësimit: Sekretariati i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, në çështjen juridike “*kompensim material*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1 nën, paragrafin 1.1, nenin 16, paragrafin 3 dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.8 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të datës 27.07.2026, mori këtë:

V E N D I M

I. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, *shpallet jo kompetent* për të vendosur lidhur me ankesën A.nr.613/2026, të datës 09.06.2026, të parashtruar nga ankuesi F.B.

II. Pala ankuese udhëzohet në kontest juridiko-civil në pajtim me dispozitat e ligjit në fuqi për procedurën kontestimore.

A r s y e t i m

Ankuesi F.B (*me tej referuar vetëm ankuesi*), më datë 09.06.2026, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, për shkak të heshtjes administrative të Sekretariatit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, ndaj kërkesës së datës 16.04.2026, lidhur me rishqyrtimin e pagesës se orëve shtesës të punës, gjatë fundjavave dhe festave zyrtare, për periudhën e angazhimit të tij gjatë muajve dhjetor 2025 dhe janar 2026.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas shqyrtimit të shkresave të lëndës ka gjetur se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil i Kosovë ***nuk është kompetent*** për të vendosur lidhur me ankesën, sepse:

I. Gjendja e fakteve

Nga provat e lëndës rrjedhë se:

- Ankuesi ka qenë i punësuar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve sipas Kontratës së Punës për periudhë të caktuar kohore me numër Ref:490/2025 të datës 09.10.2025, në pozitën *Staf Administrativ në QNR* në Prishtinë.

- Sipas Aneks Kontratës më numër 490/2025 të datës 09.10.2025, ankuesit i vazhdohet angazhimi sipas kontratës me numër 490/2025 të datës 09.10.2025 për periudhën 01.12.2025 deri me datën 31.01.2026.
- Më datë 16.04.2026, ankuesi ka parashtruar kërkesë tek Sekretariatit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, lidhur me rishqyrtimin e pagesës së orëve shtesës të punës gjatë fundjavave dhe festave zyrtare, për periudhën e angazhimit të tij gjatë muajve dhjetor 2025 dhe janar 2026, por sipas thënieve në ankesë i njëjti nuk ka pranuar përgjigje.

II. Pretendimet Ankimore

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës pretendon se nuk i është bërë kompensimi për periudhën e angazhimit të tij gjatë muajve dhjetor 2025 dhe janar 2026, ku sipas pagesës së muajit janar 2026 i janë kompensuar vetëm 40 orë punë, duke mos i përfshirë të gjitha orët e realizuara sipas angazhimeve dhe orarit të punës me gjithsej 88 orë punë, Kërkon nga Këshilli që të aprovohet ankesa në tërësi si e bazuar dhe të obligohet Sekretariati i Këshillit Qendror të Zgjedhjeve që ta shqyrtoj kërkesën e datës 16.04.2026, të bëjë kompozimin e orëve të mbetura dhe të nxjerr akt administrativ sipas legjislacioneve në fuqi.

III. Vlerësimi i Kolegjit

Në kuptim të kompetencës materiale të KPMSHCK-ës për vendosje lidhur me këtë çështje juridike-administrative, Kolegji fillimisht thekson faktin se ankuesi deri me datë 31.01.2026 kishte statusin e nëpunësit civil, rrjedhimisht, nga kjo datë ankuesi ka humbur statusin e nëpunësit civil për shkak të përfundimit të marrëdhënies së punës sipas Kontratës nr. 490/2025 të datës 09.10.2025, andaj, meqenëse ankuesi në momentin e parashtrimit të kërkesë lidhur me të drejtën e pretenduar (datë 16.04.2026), nuk ka statusin e nëpunësit civil, atëherë, duke u bazuar në nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafi 1.1 të Ligjit nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më të cilin përcaktohet së Këshilli ka juridiksion që të shqyrtoj vetëm ankesat e nëpunësve civilë dhe kandidatëve për pranim në shërbimin civil, Këshilli nuk është kompetent për të vendosur lidhur me ankesën e ankuesit A.nr.613/2026.

Referuar konstatimet si më sipër, Kolegji vlerëson se në rastin konkret kemi të bëjmë më raport juridiko-civil, kështu që, Kolegji në kuptim të informimit të palës ankuese udhëzon palën ankuese që të drejtën e tij materiale të pretenduar si në ankesë ta realizoj në kontest civil në pajtim me dispozitat e Ligjit përkatës për Procedurën Kontestimore. E në ndërlidhje me këtë fakt, Kolegji ve në dijeni palën së lënda nuk mund të bartet tek gjykata kompetente, sepse, në këtë fazë mungon padia si kusht kryesor për fillimin e një procesi gjyqësor.

Thënë si më sipër e në mbështetje të nenit 18, paragrafi 1, nën paragrafin 1.8 të Ligjit Nr.06/L048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Ky vendim hynë në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Administrative në Prishtinë- Departamenti për Konteste të Punës, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

A.nr.613/2026

Argjenda SHERIFI

Procesmbajtëse

Ardita Haxhnikaj-DEMI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- *Ankuesit F.B;*
- *Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve; dhe*
- *Arkivit të KPMSHCK-së.*